



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: 463-01/11971, dt: 28 Shkurt 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit të Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Bujar Nila, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 28 Shkurt 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 07/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Bujar Nila me qëllim të Formimit të Rrugës dhe Rregullimin e Sheshit si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të Formimit të Rrugës dhe Rregullimin e Sheshit si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr.4874-30 në sipërfaqe prej 70m² ZK Pejë, pronë e pronarit Bujar Nila do të merret për nevoja të formimit të rrugës si Interes Publik dhe Rregullimit të Sheshit sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me ngastrat kadastrale nr.6191-5 me sipërfaqe prej 87m² ZK Pejë dhe nr. 6191-6 me sipërfaqe prej 20m² ZK Pejë pronë **Komuna e Pejës**.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 12.02.2025.

-Pronat e Komunës, ngastrat kadastrale nr.6191-5 në sipërfaqe prej 87m² ZK Pejë dhe nr.6191-6 në sipërfaqe 20m² janë vlerësuar 750.00 €/m², përkatësisht totali 80,250.00 €.

-Prona private e pronarit Bujar Nila, ngastra kadastrale nr.4874-30 në sipërfaqe prej 70m² ZK Pejë është vlerësuar 140.00 €/m², përkatësisht totali 9,800.00 €.

Andaj obligohet pronari privat Bujar Nila që të paguaj diferencën në shumën prej 70,450.00 € Komunës së Pejës bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do të nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore–Juridike.

- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

